

# MANUAL

## MBI PROCEDURAT E HARTIMIT TE STRUKTURAVE DHE ORGANIKAVE TE INSTITUCIONEVE TE ADMINISTRATES QENDRORE

Ne zbatim te:

1. Neni 102 (3) te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise: “Kryeministri, ne zbatim te kompetencave te tij, nxjerr urdhra”.
2. Neni 4(4) (b) XII te ligjit “Statusi i nepunesit civil”: Departamenti i Administrates Publike i paraqet kryeministrit, me propozim te institucioneve te administrates qendrore, strukturen dhe organiken e tyre, ne perputhje me dispozitat e ligjit organik per buxhetin.
2. Udhezimi nr.1, date 13/06/2000 “Per strukturen e renditjes se puneve ne sherbimin civil, metodologjine perkatese dhe pershkrimin e rolit pergjithsues te Sekretarit te Pergjithshem ne kete sherbim”,  
Sekretari i Pergjithshem i institucionit ose njesia e personelit, ne bashkepunim me njesite e tjera te institucionit bejne rishikimin e organizimit aktual te institucionit per te permbushur mandatin dhe propozimet per ndryshimet ne funksionet specifike dhe mbeshtetese.

**Hartimi apo ndryshimi i struktures se nje Institucioni nuk eshte thjesht ceshtje organizative, por nje proces me pasoja ne fushat e meposhtme:**

- Percaktimin e numrit te punonjesve dhe alokimit racional te tyre ne njesite e vecanta.
- Percaktimin e nevojave per koordinim
- Percaktimin e duhur te standarteve ne kohen dhe menyren e qarkullimit te dokumentacionit (kur merren me te njejtat detyra te identifikuara).
- Percaktimin e nevojave dhe perdorimin eficient te burimeve ne dispozicion, perfshire skemat e teknologjise se informacionit dhe komunikimit.

**Vecorite kryesore qe duhet te karakterizojne nje strukture administrative mund te permbliiden ne kater parimet e meposhtme:**

- Strukturat te jene relativisht te qendrueshme ne afate kohore te mesme.
- Strukturat te jene relativisht homogjene nga nje institucion ne tjetrin, per te lehtesuar koordinimin nderministerial, qarkullimin e stafit dhe standartizimin e niveleve menaxhuese si dhe modulet e trainimit.
- Strukturat te jene relativisht homogjene brenda nje institucioni, me qellim qe te parandalonje krijimin e pikave te dobeta, veshtiresite e te cilave mund te krijojne nje reaksion zinxhir ne te gjitha njesite e tjera.
- Njesite elementare te struktures te jene te medha ne menyre te mjaftueshme qe te mos destabilizohen nga mungesa per arsye te thjeshta te cfaredo lloji. Kjo ka efekte te rendesishme anesore:
  - Kryerjen e procesit te rekrutimit ne perputhje me procedurat ligjore (dhe jo plotesimin e vendeve te lira me kontrata te perkohshme)

- Avantazhin e transmetimit te memories institucionale (transmetimin e njohurive brenda kuadrit te nje njesie midis kolegeve me eksperience dhe atyre te rinj).

Ne pregatitjen e dokumentacionit qe pershkruan strukturen dhe organigramen e nje ministrie duhet te mbahen parasysh disa pyetje standarte qe duhet te sherbejne si udhezues gjate procesit te ristrukturimit.

1. Cili eshte misioni i Njesise dhe baza ligjore mbi te cilet mbeshtetet krijimi i saj?
2. A eshte i nevojshem krijimi i kesaj njesie?
3. Cilat jane funksionet e Njesise?
- 4 Si eshte i lidhur misioni i ministrise me misionin e perbashket te institucionit, ne cilin objektiv specifik kontribuon dhe ne c'mase?
5. A nevojitet ky funksion per te ruajtur sigurine publike, per te mbrojtur pronen shteterore, per te stimuluar ose ruajtur nivelin ekonomik, apo per te rritur cilesine e jetes se shoqerise?
6. A mundet qe funksionin ne fjale ta kryejne institucione joqeveritare (private ose jofitimprurese)?
7. A mundet qe nje nga funksionet te realizohet nga organet e pushtetit lokal?
8. A ekziston mbivendosja e ketij aktiviteti dhe me ministri te tjera?
9. A ekziston nje lloj i ngjashem funksioni ne ministrite e tjera ku mund te transferohet?
10. A realizohet ky funksion nga sektori i pershtatshem?
11. A ka nje bashkepunim me sektoret e tjere brenda ministrise?

Organigramen model te nje ministrie do ta ndanim ne tre nivele per ta bere me te qarte.

## **1. NIVELI POLITIK**

Eshte niveli ku mbi draftet politike te propozuara nga sherbimi civil, realizohet procesi i vendimmarrjes.

### ***Ministri***

Ai eshte drejtuesi politik i ministrise, i cili propozohet nga Kryeministri dhe emerohet nga Presidenti i Republikes. Gjithashtu ai eshte anetar i Keshillit te Ministrave.

### ***Zevendesministri***

Ai emerohet nga Keshilli i Ministrave. Si person politik ai kryen detyra te tilla te deleguara nga ministri, pergjithesisht koordinimin politik brenda ministrise.

Pervec pergjegjesive te tyre te rastit, ne nenin 14.4 te Ligjit mbi Keshillin e Ministrave, qe lidhen e seksionet e tjera te meposhtme ne to, Zv/Ministri:

a) mund te ushtroje fuqine e tij deleguese ne disa sfera te kompetences se Ministrise

b) mund te ushtroje kompetenca te dores se dyte ne emer te Ministrit ne te gjithe Ministrine.

### ***Kabineti i Ministrit***

Drejtohet nga Shefi i Kabinetit dhe eshte pergjegjes perpara Ministrit. Kabineti perbehet nga dy pjese:

-keshilltaret politike, te cilet emerohen nga ministri-jo me shume se tre vete;  
-sekretaria me pergjegjesine per te ndihmuar ose lehtesuar veprimtarine e zyres se ministrit dhe nderveprimin ndermjet ministrit dhe nepunesve te ministrise-jo me shume se dy vete.

## **2. SHERBIMI CIVIL**

Ne kete nivel perpunohet dhe analizohet informacioni dhe mbi kete baze formulohen draftet politike duke ndjekur hapat hierarkike ne sherbimin civil. Gjithashtu, ketu behet dhe monitorimi i zbatimit te vendimeve politike ne fushen perkatese qe mbulon ministria.

### ***Sekretari i Pergjithshem***

Sekretari i Pergjithshem eshte nepunesi civil i nivelit me te larte ne ministri.  
Sekretari i Pergjithshem eshte drejtuesi profesional i perhershem i administrates. Nen autoritetin (politik) te Ministrit, Sekretari i Pergjithshem eshte pergjegjes per drejtimin e pergjithshem te te gjitha sherbimeve dhe koordinimin midis tyre.

### ***Drejtori e Pergjithshme (Departament)***

Ne cdo Ministri mund te kete drejtori te pergjithshme qe drejtohen nga Drejtori i Pergjithshem, i cili pergjigjet tek Sekretari i Pergjithshem per:

-menaxhimin dhe zgjidhjen e problemeve profesionale dhe organizative te njesise qe mbulon  
-pregatitjen dhe kontrollin e zbatimit te buxhetit brenda fushes se tyre te menaxhimit  
-keshillon drejtuesit e institucionit per probleme qe lidhen me fushat e tyre te kontrollit  
-perfaqeson ministrine ne bisedime me organizata dhe institucione te rendesishme kombetare/ te huaja dhe nderkombetare.

### **Keto drejtori jane:**

- drejtori te pergjithshme teknike-jo me shume se kater- te cilat kryejne funksionet kryesore qe lidhen me mandatin specifik te ministrise;
- drejtori te pergjithshme mbeshtetese-jo me shume se dy-te cilat kryejne funksione te pergjithshme (te njejta per te gjitha ministrite) sic jane analiza dhe planifikimi ekonomik, pergatitja dhe monitorimi i buxhetit, menaxhimi financiar, etj., dhe te cilat nuk jane specifike per mandatin e ministrise.

Drejtoria e pergjithshme ka ne perberje te saj jo me pak se dy drejtori.

## ***Drejtoria***

Drejtorite drejtohen nga Drejtori qe eshte pergjegjes perpara Sekretarit te Pergjithshem/ Drejtorit te Drejtorise se Pergjithshme per aktivitetin e nje drejtorie funksionale/profesionale.

*Drejtorite mund te jene:*

- drejtori teknike- jo me shume se gjashte -te cilat kryejne funksionet kryesore qe lidhen me mandatin specifik te ministrise
- drejtori mbeshtetese-jo me shume se tre- te cilat kryejne funksione te pergjithshme (te njejta per te gjitha ministrite) sic jane analiza dhe planifikimi ekonomik, pergatitja dhe monitorimi i buxhetit, menaxhimi financiar, menaxhimi i burimeve njerezore etj., te cilat nuk jane specifike per mandatin e ministrise.

Drejtoria ka ne perberje te saj jo me pak se dy sektore. Drejtorite qe ne strukture nuk kane sektore, duhet te kene ne perberje jo me pak se 4 specialiste.

## ***Sektoret/Zyrat***

Drejtohen nga pergjegjesi i sektorit qe eshte pergjegjes perpara Drejtorit te Drejtorise. Ato jane njesi pergjegjese per nje aspekt te caktuar te aktivitetit qe mbulon Drejtoria. Pervec pergjegjesit te sektorit, ne perberje te sektorit duhet te kete jo me pak se dy punonjes. Pergjegjesi i Sektorit mund te mbuloje dhe nje sektor te madh me personel jo specialist qe kryejne detyra operacionale/administrative.

## ***Specialistet***

Specialisti pergjigjet perpara Pergjegjesit te Sektorit/Drejtorit ne analizen dhe sintetizimin e informacionit dhe vleresimin e propozimeve.

## **3. NIVELI EKZEKUTIV**

Eshte niveli ku behet zbatim konkret i politikave dhe programeve qeveritare.

**Ky nivel perfaqesohet nga :**

- Drejtorite Operacionale ne qarqe (Drejtorite arsimore, Drejtorite e Shendetit Publik, etj.) te cilat bejne zbatimin e politikave dhe programeve te Ministrise perkatese ne zonen konkrete gjeografike.
- Drejtorite e pergjithshme zbatuese (Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, Drejtoria e pergjithshme e Krugeve, etj.) qe kane si detyre kryesore zbatimin e politikave dhe programeve qeveritare te nje fushe specifike, ne te gjithe territorin e vendit.
- Institucione te tjera te varesise, me misione qartesisht te percaktuara